



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 2082 Prot.

Tiranë, më 12 / 05 /2026

**Lënda:** Përcillen Amendamente në projektrezolutën “Për procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”

**Drejtuar:** **Z. Niko PELESHI**  
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

**Z. Igli Hasani**  
Kryetar i Komisionit Parlamentar për Europën dhe Punët e Jashme

Të nderuar,

Shqipëria ndodhet në një moment kyç në procesin e integritit evropian, që duhet të shërbejë edhe si një mundësi për të forcuar demokratizimin e institucioneve shqiptare, përfshirë funksionimin demokratik të Kuvendit të Shqipërisë. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dëshiron që Shqipëria të ecë drejt Bashkimit Evropian jo përmes propagandës boshe, por përmes standardeve të mirëfillta dhe institucioneve që funksionojnë në mënyrë demokratike, duke nisur nga institucioni që përbën thelbin e Republikës sonë – Kuvendi i Shqipërisë.

Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, i ndryshuar, si dhe pikave 3 dhe 4 të nenit 103/1 të Rregullores së Kuvendit, bashkëlidhur do të gjeni Amendamentet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në projektrezolutën “Për procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të përfshira në një tekst integral.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE**

**GAZMENT BARDHI**

**KRYETAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKT

REZOLUTË

PËR PROCESIN E ANËTARËSIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
BASHKIMIN EVROPIAN

*Duke rikonfirmuar se anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian përbën objektiv strategjik kombëtar, që udhëheq dhe orienton të gjithë agjendën reformuese të vendit për transformimin demokratik, institucional, ekonomik dhe social;*

*Duke theksuar se orientimi evropian është zgjedhje natyrale dhe strategjike mbarëkombëtare, që gëzon mbështetje të gjerë qytetare dhe përfaqëson një angazhim të qëndrueshëm ndaj vlerave themelore të Bashkimit Europian, demokracisë, shtetit të së drejtës, lirisë, paqes dhe bashkejteses, barazisë dhe dinjitetit njerëzor;*

*Duke pasur parasysh kriteret e Kopenhagës dhe parimin se procesi i anëtarësimit bazohet në meritë, kushte të drejta dhe zbatim real të reformave, në përputhje me standardet demokratike dhe respektimin e të drejtave themelore;*

*Të vetëdijshëm se Shqipëria ka hapur me shpejtësi të gjithë kapitujt e negocimit dhe është në pritje të miratimit të raportit IBAR;*

*Duke vlerësuar se procesi i zgjerimit të BE-së po zhvillohet në një kontekst gjeopolitik të ndjeshëm që kërkon riformësim të shpejtë të institucioneve dhe përparim të matshëm në fushat kyçe si:*

- funksionimin demokratik të institucioneve
- gjyqësorin dhe të drejtat themelore,
- drejtësinë, lirianë dhe sigurinë,
- prokurimin publik
- kontrollin financiar
- statistikat
- kriteret ekonomike dhe
- reforma në administratën publike;

*Duke marrë në konsideratë Raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë 2025 dhe Raportin e Parlamentit Evropian për Shqipërinë, miratuar në 5 maj 2026 në Komisionin për Punët e Jashtme të Parlamentit Europian (AFET);*

*Duke shqyrtuar Raportin Final të OSBE/ODIHR për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, që evidenton problematika serioze lidhur me keqpërdorimin e burimeve shtetërore për qëllime partiake, duke krijuar paqartësi të ndarjes midis institucioneve shtetërore dhe strukturave partiake, blerjen e votës, presionin ndaj administratës dhe votuesve, si dhe shkeljen e fshehtësisë së votës, të cilat cenojnë standardet e zgjedhjeve të lira e të ndershme;*

*Duke marrë në konsideratë gjetjet e Institutit V-Dem (2026), që e klasifikon Shqipërinë si "autokraci elektorale", Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International 2025, që shënon rënie me 11 vende, si dhe raportin e Reporterëve pa Kufij (RSF) për vitin 2025, që evidenton rënie me 3 vende në indeksin e lirisë së medias;*

*Të vetëdijshëm se procesi i zgjerimit bazohet në meritokraci, kushtëzim të drejtë dhe zbatim real të vërtetë të reformave;*

*Duke theksuar se integrimi europian kërkon transformim thelbësor, që përfshin jo vetëm harmonizim formal të ligjeve, por zbatim të plotë, rezultate konkrete dhe të matshme, përgjegjësi institucionale dhe gjithëpërfshirje;*

*Duke nënvizuar përgjegjësinë kushtetuese të Kuvendit të Shqipërisë për mbikqyrjen e procesit të integritetit, forcimin e kontrollit parlamentar dhe garantimin e transparencës;*

*Duke marrë në konsideratë nevojën urgjente për të forcuar besimin publik, për të garantuar ndarje efektive të pushteteve, funksionim real të mekanizmit të kontrollit dhe balances, pavarësi institucionale dhe përfshirjen reale të opozitës në funksione parlamentare dhe vendimmarrje të rëndësishme kombëtare;*

*Duke shprehur vlerësimin për mbështetjen (strategjike dhe financiare) e gjithaneshme të Bashkimit European për Shqipërinë;*

### **KUVENDI I SHQIPËRISË ANGAZHOHET:**

1. Të ushtrojë në mënyrë të plotë dhe efikase funksionin ligjbërës dhe mbikqyrës për procesin e integritetit europian, duke garantuar cilësinë e legjislacionit, përafrimin me *acquis communautaire* dhe zbatimin e tij konkret në praktikë.
  2. Të forcojë kontrollin parlamentar mbi ekzekutivin, veçanërisht lidhur me financat publike, prokurimet, koncesionet, fondet e BE-së dhe përdorimin e burimeve shtetërore, duke rritur transparencën, auditimin e pavarur dhe llogaridhënien.
  3. Të sigurojë pjesëmarrje të plotë të opozitës në veprimtarinë parlamentare, të respektojë kërkesat e saj në përputhje me standardet demokratike, me Kushtetuten dhe Rregulloren e Kuvendit, si garanci për funksionimin real të pluralizmit politik dhe përmirësimin e klimës së dialogut.
-

4. Të kërkojë zbatim të plotë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias, për garantimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe ndarjen të shtetit nga partia.
5. Të sigurojë respektim të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të institucioneve të pavarura, si themel i shtetit të së drejtës dhe kusht për progres në negociatat me BE-në.
6. Të kërkojë forcim të rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar, duke garantuar mbështetje të plotë për institucionet përkatëse dhe zbatimin e rekomandimeve të BE-së.
7. Të kërkojë përmirësimin e mekanizmave të mbrojtjes së gazetarisë së lirë, transparencës së pronësisë së medias dhe pavarësisë editoriale, duke garantuar mjedis mediatik konkurrues dhe të paanshëm.
8. Të angazhohet në luftën kundër dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja, për mbrojtjen e integritetit të proceseve demokratike dhe të interesave strategjike kombëtare.
9. Të nxisë dialog politik dhe shoqëror gjithëpërfshirës, për të siguruar konsensus kombëtar mbi prioritetet europiane.
10. Të forcojë partneritetin ndërparlamentar me Parlamentin Europian dhe parlamentet e vendeve anëtare të BE-së, duke kontribuar aktivisht në diplomacinë parlamentare dhe marrëdhëniet me parlamentet homologe.
11. Të refuzojë çdo nismë, akt apo veprim që devijon nga kursi i qenësishëm i anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

#### **KUVENDI I SHQIPËRISË I KËRKON KËSHILLIT TË MINISTRAVE:**

1. Të garantojë zbatim të plotë dhe të qëndrueshëm të legjislacionit në përputhje me acquis të BE-së, duke përshpejtuar reformat në shtetin e së drejtës, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjyqësor dhe fushat e tjera të grupkapitullit Themeloret.
2. Të ndërmarrë masa të qarta për ndarjen e shtetit nga partitë ose nga partia ne pushtet, parandalimin e keqpërdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale dhe depolitizimin e administratës.
3. Të garantojë zbatim të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe respektimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura.
4. Të sigurojë pavaresi funksionale dhe burime të mjaftueshme për institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

5. Të forcojë transparencën dhe konkurrencën në prokurime, koncesione, investime strategjike dhe planifikim urban.
6. Të garantojë pluralizëm mediatik dhe mbrojtje të gazetarëve nga presioni politik ose ekonomik.
7. Të përshpejtojë procesin e depolitizimit të administratës publike, të rrisë efikasitetin e saj dhe të zbatojë me përpikëri kriterin e meritës në rekrutime.
8. Të mbrojë mjedisin dhe zonat e mbrojtura, në përputhje me standardet e BE-së,
9. Të rrisë transparencën për investimet strategjike.
10. Të sigurojë transparencë, kontroll efektiv dhe përgjegjësi të qarta në përdorimin e fondeve të BE-së, përfshirë zbatimin e masave korigjuese mbi çështjet e evidentuara nga OLAF.
11. Të garantojë konsultim real dhe gjithëpërfshirës me opozitën, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, për të shmangur centralizimin politik të procesit të integrimit.
12. Të forcojë kapacitetet e strukturave që koordinojnë dhe negociojnë me Bashkimin European.
13. Të intensifikojë informimin publik mbi përfitimet dhe përgjegjësitë e anëtarësimit në BE.
14. Të heqë dorë nga çdo nismë që minon, vonon ose devijon procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European.

## KUVENDI I SHQIPËRISË

Rithekson se progresi në procesin e anëtarësimit duhet të matet mbi bazën e meritës, standardeve demokratike dhe arritjeve të verifikueshme, me qëllim që Shqipëria të ecë me hapa të qëndrueshëm drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin European.

Miratuar më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2026

**KRYETARI**

**NIKO PELESHI**

---